



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e  
Komuniteteve dhe Kthim**

**Legjislatura e III-të**  
**Nr. 05/08**  
**Prishtinë, më 9.05.2008, ora 13:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e  
Komuniteteve dhe Kthim

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Bojan Stojanoviq , Sanije Aliaj, Müfera Şinik, Kosara Nikolić, Numan Balić, Hafize Hajdini, Hetem Arifi, Zylfi Merxha, Mursejl Haljilji, Enis Kervan, Xhevdet Neziraj, Zafir Berisha.**

**Anëtarët jo të pranishëm: Sadik Idriz .**

Gjithashtu të pranishëm ishin: monituroes nga Zyra e Presidentit, KDI.

Nga shërbimi i sekretarisë: Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

**Kryesues: Bojan Stojanoviq, kryetar i komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën Jokontestimore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën Përmbaruese me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;**

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;
8. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente;
9. Të ndryshme.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe njoftoi anëtarët se ka ndodhur një ndryshim i ditës së mbajtjes së mbledhjes për shkak se të Mërkurën nuk ka mundur të jetë i pranishëm. Më pas propozoi rendin e ditës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen për këtë rend dite.

Rendi i ditës u miratua si i tillë i propozuar.

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 22.04.2008, u miratua pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën Jokontestimore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente**

**Kryetari** kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë dhe shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, me votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin për Procedurën Jokontestimore dhe të njëjtin e përkrahu me konstatimin se dispozitat e tij nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.
  - II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, të njëjtin e përkrahu me konstatimin se amendamentet nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.
- ## **4. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën Përmbartuese me raportin e komisionit funksional- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente**

**Kryetari** kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë dhe shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, me votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin për Procedurën Përmbaruese dhe të njëjtin e përkrahu me konstatimin se dispozitat e tij nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.
- III. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe të njëjtin e përkrahu me konstatimin se amendamentet nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.
5. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente**

**Kryetari** njoftoi anëtarët se ky Projektligj nuk është miratuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa andaj edhe propozoi që shqyrtimi dhe miratimi i tij të bëhet pas miratimi nga ky komision.

**Xhevdet Neziraj** në cilësinë e anëtarët të Komisionit për Buxhet dhe Financa, njoftoi se arsyeja e mos miratimit nga ky komision ka ardhur me kërkesën e një anëtare e cila ka theksuar se disa amendamentet që janë pasqyruar në raportin e komisionit funksional nuk janë votuar nga komisioni dhe anëtarët e komisionit nuk janë në dijeni për ato. Mbështeti kërkesës që ky projektligj me amendamentet e propozuara të shtyhet deri në marrjen e raportin nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

**Müfera Şinik** theksoi se në amendamentet e propozuara ka mosharmonizim në mes gjuhës shqipe dhe serbe, kjo vërehet veçanërisht në amendamentin 29.

Pas sqarimeve dhe propozimeve të dhëna, me votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **K O N K L U Z I O N**

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim vendosi që Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente, të shqyrtoi dhe miratoi pas marrjes së raportit nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

6. **Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente**

**Kryetari** kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë dhe shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, me votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

## R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme dhe të njëjtin e përkrahu me konstatimin se dispozitat e tij nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.
  - II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamentet të komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe të njëjtin e përkrahu me konstatimin se amendamentet nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente**

**Kryetari** njoftoi anëtarët se edhe ky Projektligj nuk është miratuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa andaj edhe propozoi që shqyrtimi dhe miratimi i tij të bëhet pas miratimi nga ky komision.

**Xhevdet Neziraj** theksoi se komisioni për Buxhet dhe Financa ka shtyrë miratimin e këtij projektligji për arsye se amendamentet e propozuara kanë gabime të mëdha gjuhësore të cilat do ta bënin përmbajtjen Ligjit e tij më abstrakte. Komisioni ka vendosur që të ftojë Ministrin përkatës dhe kryetarin e komisionit funksional në mënyrë që të jepen sqarimet dhe të evitohen gabimet.

Pas vërejtjeve dhe sqarimeve të bëra, me votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

## K O N K L U Z I O N

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim vendosi që Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente, të shqyrtoi dhe miratoi pas marrjes së raportit nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

- 8. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente**

**Kryetari** theksoi se është anëtar i komisionit funksional që ka propozuar amendamentet dhe ato nuk përmbajnë dispozita që do të cenoni të drejtat dhe interesat e komuniteteve, prandaj edhe kërkoi nga anëtarët ta miratojnë atë.

Pasi që nuk kishte vërejtje, me votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

## R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve dhe të njëjtin e përkrahu me konstatimin se dispozitat e tij cenojnë drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamentet të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe të

njëjtin e përkrahu me konstatimin se amendamentet nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.

## 9. Të ndryshme

**Kryetari** theksoi se nuk ka qenë i njoftuar për mbledhjen e mbajtur më 22 prill dhe siç jemi marrë vesh mbledhja e radhës do të duhej të ishte më 29 prill. Sido që të jetë nuk jam kundër por do të ishte mirë që të isha i informuar. Sa përket zbatimit të planit, konkretisht vizitave në teren, tha se është në kontakt me OSBE-në dhe do të realizohen së shpejti. Gjithashtu jemi në kontakt më kuvendet komunale në Lipjan dhe Mamush dhe pas përgatitjeve që do të bëhen do të shkohet atje. Rreth vizitës në Zvicër ende nuk kam përgjigje.

**Enis Kervan** theksoi se ka kontaktuar me autoritetet komunale në Mamush dhe për shkak të festave ende nuk jemi marrë vesh rreth ditës së vizitës. Vizita do të ndodh në mënyrë të përgatitur pas marrjes së axhendes. Lidhur me mbledhjen e 22 prill, kjo ka ndodhur për shkak të nevojës urgjente që Ligjet të kalojnë në Kuvend për miratim të dytë. Mbledhja është mbajtur ashtu siq jemi pajtuar, që në rast nevojë, në mungesë të kryetarit mbledhjet mund të kryesojë zëvendëskryetari. Por sido që të jetë ju do të duhej të informoheni.

**Sanije Aliaj** lidhur me mbajtjen e mbledhjes më 22 prill dhe kryesimit nga ana e saj, theksoi se ka qenë e ftuar nga administrata për të udhëhequr dhe nuk është në dijeni për mosinformimin e kryetarit. Mbajtja e mbledhjeve është e përcaktuar me Rregulloren e punës së Kuvendit dhe mbajtja e tyre kushtëzohet nga vëllimi i punëve në Kuvend që duhet proceduar brenda afateve procedurale. Znj. Aliaj kërkoi që të fillohet me vizitat nëpër teren në mënyrë që të jetësohet plani punës. Gjithashtu kërkoi që përfaqësuesit e Ministrive dhe përfaqësuesit tjerë, për të cilët jemi pajtuar të vijnë rregullisht në mbledhje.

**Numan Balić** vlerësoi rëndësinë e unitetit në mes anëtarëve në mënyrë që puna e komisionit të jetë e suksesshme. U pajtua se nëse është kryetari, ai duhet udhëhequr mbledhjen, por në rast mungesës së tij anëtarët të merren vesh për mbajtjen e mbledhjeve. Kërkoi që të njoftohen me kohë për mbledhje dhe ato të mbahen në kohë të përshtatshme dhe ato të mos jenë në ditët dhe kohën në kur kemi obligime tjera. Të punojmë harmoni dhe në gjendje normale për një punë të efektshme.

**Mursejl Haljilji** përkrahu mendimin e z. Balić se duhet njoftuar me kohë për mbledhje. Theksoi se nuk ka qenë i informuar për mbledhjen e 22 prill dhe ka menduar se mbledhja e radhës do të duhej të ishte më 29 prill ashtu siq ishin pajtuar.

**Zylfi Merxha** kërkoi që mbledhjet t'i caktoj kryetari e jo stafi mbështetës. Bëri vërejtje edhe sa i përket vizitave jashtë vendit. Z. Merxha tha se komisionet tjera kanë filluar vizitat ndërsa ne ende jo ndoshta është edhe fakti se jemi komisioni për pakica.

**Xhevdet Neziraj** kërkoi që të ftohen ministrat sidomos ministri i pushtetit lokal dhe ministri i komuniteteve ose këshilltarët e tyre në mënyrë që të konsultohemi rreth çështjeve që kanë të bëjnë me projektet prioritare për komunitetet. Të marrim pjesë aktive si komision në caktimin e këtyre prioriteteve e jo të shëndrrohem në instrument votimi, ndërsa të tjerët të vendosin për ne, siç ka ndodhur në mandati e kaluar. Të ftohet UNDP-ja që të raportoj për punën e saj lidhur me projektet që kanë të bëjnë me komunitetet.

**Kosara Nikolić** duke pasur parasysh faktin se shumica e anëtarëve jemi në disa komisione, kërkoi nga stafi mbështetës që të konsultohet për kohën e mbajtjes së mbledhjeve e cila nuk do të duhej të ishte e njëjtë me kohën që ka caktuar një komision tjetër.

**Kryetari** ofroi përkrahjen për secilin anëtarë, të cilët mund të konsultojnë në zyrën e tij në Kuvend çdo ditë lidhur me problemet që kanë të bëjnë me komunitetet. U pajtua me mendimet e parafolësve se duhet monitoruar puna e Ministrive të lartpërmendura dhe të ftohen ministrat për të dhënë raport në komision. Por kërkoi të ftohen edhe organizata tjera që implementojn projektet që kanë të bëjnë me komunitetet, siç është UNDP-ja e cila shpenzon mjetet nga buxheti i Kosovës, ndërsa përgjegjësinë e shpenzimit të tyre bie mbi Ministrinë për Komunitete. Po ashtu premtoi se vizitat në Kuvendet Komunale do të bëhen pas koordinimit i tyre. Propozoi që mbledhjet të mbahen sipas nevojës dhe t'i përshtaten mundësisë së pjesëmarrjes së të gjithë anëtarëve.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00

Shërbimi i komisioneve

**Kryetari i Komisionit**

**Bojan STOJANOVIĆ**

